



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

28 qershor 2023
Prishtinë

Përmes mjeteve të informimit jemi njoftuar se tre mjekë anëtarë të OMK-së, të punësuar në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, janë arrestuar nga Policia e Kosovës nën dyshimin se me rastin e ofrimit të shërbimit shëndetësor nuk ka kanë treguar vigjilencë të mjaftueshme profesionale dhe si pasojë e neglizhencës është shkaktuar pasoja e pretenduar dhe e kundërligjshme.

Është e papranueshme që në sistemin e drejtësisë është sajuar një parktikë e tillë sipas së cilës mjafton që të bëhet një lajmërim policor dhe se me një deklartë të vetme, pa u njoftuar në mënyrë më të quartë për të vërtetuar ekzistimin e dyshimit të bazuar se është kryer vepra penale, mjekët të prangosen e të mbahen në kufizim të lirisë vetëm në bazë të deklaratave hipotetike dhe pa asnjë bazë profesionale. Trajtimi i mjekëve në mënyrë të tillë, duke i arrstuar në vendin e punës dhe duke i zbatuar masat më të rënda e represive ligjore, e denigron figurën e mjekut në shoqerinë tonë, e për më keq, e stigmatizon dhe e sjellë në pozitë paragjykuese me bazë kriminale në shoqëri.

OMK asnjëherë nuk ka proklamuar qëndrime amnistuese ndaj keqbërësve dhe kryesve potencial të veprave penale, kushdo qoftë personi i cili ndërmerr veprime të tillë. Mirëpo ne kundërshtojmë dhe e konsiderojmë si të papranueshme qasjen dhe trajtimin që i bëhet mjekëve në raste të tillë dhe se aplikimi i masave më të rënda parapenale pa i analizuar mirë rr Ethanat dhe kushtet ligjore, në të paktën është shkelje të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare.

I bëjmë thirrje të gjitha organeve ligjzbatuese, që me rastin e trajtimit të veprave që kryhen me rastin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, veçanërisht kur mjekët janë subjekt i procedurës, t'i trajtojnë ata sipas profilit shoqëror dhe profesional që kanë, duke mos lejuar në asnjë mënyrë që atyre t'iu mëveshet petku kriminal.

Prishtinë, 28 qershor 2023

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdini, M.Sc

